



N.SH. "Drinia Net"  
Pronar: Mentor Dulaj  
OK "N.SH. "Drinia Net"  
Ratkoc  
Rahovec

VENDIMI: LIC/KPM-2013/09  
Ref: 1301/200/KPM/ni

### VENDIM

*lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllor, N.SH. "Drinia Net"-Rahovec*

### Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
1. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
2. Kandidati për operator kabllor N.SH. "Drinia Net", ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operator kabllor më datën 10 tetor 2012.

### Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja".
5. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor N.SH. "Drinia Net" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
6. Me Rregulloren për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj KPM, vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
7. Operatori kabllorë N.SH. "Drinia Net", do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij, vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Prishtina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

8. Nëse, pas marrjes së licencës, operatori kabllor N.SH. "Drinia Net" siguron marrëveshje shtesë apo të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerohë listën e programeve të kandidatit. Operatori kabllor N.SH. "Drinia Net" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t'i ketë siguruar ato.
9. KPM, vlerëson se N.SH. "Drinia Net" ka paraqitur aplikacionin në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me rregulloren për Marrjen e Licencës së KPM-së (CIMC 2009/02).
10. Prandaj, KPM-së vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor N.SH. "Drinia Net" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### Vendim

11. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se N.SH. "Drinia Net" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në Ratkoc, komuna e Rahovecit.
12. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që operatorit kabllor N.SH. "Drinia Net", i cili planifikon të operojë në Ratkoc komuna e Rahovecit, t'i lëshoj licencën e KPM-së, për të ofruar përmes rrjetit kabllor, shërbime të programeve, për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor N.SH. "Drinia Net" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
14. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1 të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediave audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencë të Operatorëve Kabllorë, është i përcaktuar me Nenin 4.2.1. të rregullores së lartpërmendur në këtë paragraf.
15. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02 përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve programore "N.SH. "Drinia Net"" duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.
16. Operatori kabllor N.SH. "Drinia Net", mund të fillojë me ofrimin e listës së programeve për klientët, vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

### Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon KPM.

Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media.



28.12.2012

data